



K.DH.SH.II.nr.1034/22

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija Ymeri, kryetare e kolegjit, Faton Bajrami dhe Saranda Bogaj Sheremeti, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Global Trade AF” me seli në Fushë Kosovë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson A.K., avokate në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK), në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.452/20, të datës 06.10.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 11.07.2023, merr këtë:

### **A K T V E N D I M**

**Aprovohet** si e bazuar ankesa e paditësit “Global Trade AF” me seli në Fushë Kosovë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative Divizioni Fiskal, A.nr.452/20, të datës 06.10.2021, **Prisheet** dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë, në rigjykim dhe rivendosje.

### **A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.452/20, të datës 06.10.2021 është refuzuar kërkesëpadia e paditësit “Global Trade AF” me seli në Fushë Kosovë si e pa bazuar, ashtu që është lënë në fuqi aktvendimi i të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, nr.06.2/508/2016 i datës 22.01.2020.

Kundër këtij aktgjykimi paditësi, përmes përfaqësueses së autorizuar, ka ushtruar ankesë për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës LKA-së konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale. Me propozim që të aprovohet ankesa

si e bazuar me ligj, të ndryshohet aktgjykimi i goditur me ankesë, ashtu që të aprovohet padia dhe kërkesëpadia e paditësit të anulohet vendimi i të paditurës nr. 06.2/508/2016 i datës 22.01.2020 dhe të detyrohet e paditura Dogana e Kosovës që të paguaj shumën prej 500.00€ me kamatë ligjore 8% nga data 01.06.2016 deri në plotfuqishmërinë e vendimit nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë apo të prish aktgjykimin e goditur me ankesë dhe ta kthej çështjen në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, përgjigjen në ankesë dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA, nenit 81.H të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative ( LKA ), gjeti se:

Ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e kundërshtuar, nr.06.2/508/2016 i datës 22.01.2020 të Doganës së Kosovës në Prishtinë, është refuzuar kërkesa e subjektit në procedurë “Global Trade AF” me seli në Fushë Kosovë, për rishqyrtimin e aktvendimit nr.08.1.2-2016-217/2 datë 01.06.2016 të lëshuar nga Drejtoria Rajonale Prishtinë-Njësi i PAKD-së, si e pa bazë.

Paditësi i pakënaqur me vendimin e Doganës së Kosovës, ka ushtruar padi për konflikt administrativ, me pretendim se i njëjti është i pa drejtë dhe i paligjshëm. Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër vendimit, nr. 06.2/508/2016 i datës 22.01.2020 të Doganës së Kosovës në Prishtinë, në seancën e shqyrtimit kryesor e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin padinë e paditësit e refuzon si të papabazuar, duke lënë në fuqi aktvendimin e të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë nr.06.2/508/2016 i datës 22.01.2020.

Gjykata e shkallës së parë, pasi vlerësoi aktvendimin e kundërshtuar dhe pas administrimit të provave si dhe dokumentacioni që gjendet në shkresat e lëndës, vendosi që ta refuzoj kërkesëpadinë e paditësit. Me arsyetim se e paditura në rivendosje ka dhënë sqarime të mjaftueshme lidhur me vërejtjet e gjykatës përkitazi me konstatimin e origjinës së mallit lëndor të deklaruar me Deklaratën Unike Doganore R-22594/30.05.2016 e paditura ka bërë të ditur se gjatë procedimit administrativ nga Sektori për Pajtueshmërinë me Procedurat Operative është

siguruar tabela me barkode sipas së cilës malli lëndor ka barkodin nacional të Polonisë dhe në anën tjetër nga dokumentacioni i bashkëngjitur vërehet se dokumenti i origjinës EUR-1 ka të përkthyer numrat tarifor të mallit të cilët kanë origjinë nga EU, po ashtu në anën tjetër gjatë procedimit administrativ nga Sektori për Pajtueshmërinë e Procedurave Operative, është siguruar tabela me barkode sipas së cilës malli lëndor ka barkodin nacional të Polonisë. Nga kjo gjendje faktike e dokumentacionit të siguruar gjatë procedurës së rivendosjes nga e paditura, gjykata konstaton se në procedurën administrative gjendja faktike është vërtetuar drejtë kur është nxjerr konkluzioni se paditësi nuk ka paraqit saktë kodin tarifor për mallin lëndor me Deklaratën Doganore R-22594/30.05.2016, emërtimi 01 deri në emërtimin 12. Me rastin e përpilimit të Deklaratës doganore paditësi nuk i ka ofruar shënime të nevojshme të mallit lëndor sipas dokumentacioneve përcjellëse. Gjkata e pranon si të drejtë konstatimin e të paditurës se paditësi ka bërë deklaram të pasaktë të mallit lëndor pasi që në rastin konkret kemi të bëjmë me mallin doganor me origjinë nga Shteti i Polonisë dhe jo nga Kina. Lidhur me pretendimet e paditësit se nuk është vërtetuar gjendja faktike nga e paditura, gjykata nga administrimi i provave nuk ka mundur të mbështesë këtë pretendim pasi që gjendja faktike e përgjegjësisë së paditësit për mos deklarim të saktë të shënimeve të nevojshme të mallit, rezulton nga certifikata e origjinës së mallit EUR-1 dhe barkodeve nacionale të shteteve përkatëse nga të cilat fakte vërtetohet se paditësi nuk iu ka përmbajt deklarimit të dhënave të mallit si në DUD-in R-22594/30.05.2016.

Dhoma e Shkallës së Dytë, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes dhe duke i shqyrtuar vendimet e organit të paditur, aktgjykimin e ankimuar të gjykatës së shkallës së parë, si dhe shkresat e tjera të lëndës, gjen se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 183 paragrafi 1, vërtetimin e gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike dhe zbatim i gabuar i të drejtës materiale nga neni 184 i LPK-së.

Kolegji i kësaj gjykate vlerëson se në procedurë gjyqësore të konfliktit administrativ shqyrtohet dhe vlerësohet ligjshmëria e një akti administrativ përfundimtar si në këtë rast, sipas dispozitave ligjore të LKA-së, LPK-së dhe ligjeve materiale. Në rastin konkret, gjykata e shkallës së parë ka refuzuar kërkespadinë e paditësit pa e vërtetuar në tërsi gjendjen faktike të dokumentacionit përcjellës që e ka shoqëruar me DUD-in R-22594/30.05.2016. Kolegji vlerëson se Gjkata e shkallës së parë në këtë rast ka refuzuar kërkespadinë e paditësit mbi bazën e provave të administruar në seancën gjyqësore të dt.06.10.2021. Nga këto prova të administruara nuk gjendet fatura nr.FAEX/00042/2016 e datës 27.04.2016 në emër të së cilës është bërë pagesa bankare e datës 01.06.2016, po ashtu është bashkëngjitur edhe certifikata e origjinës së mallit EUR-1 dhe e cila provë ka qenë vendimtare me rastin e vendosjes lidhur me kërkesëpadinë e paditësit nga

gjkata e shkallës së parë. Prandaj edhe kolegji pranon pretdimet ankimore të paditësit, se gjykata e shkallës së parë nuk ka shqyrtuar drejtë provat e paraqitura nga paditësi në padinë e tij.

Në ri procedurë Gjykata e shkallës së parë, duhet ti shqyrtojë të gjitha vërejtjet e dhëna nga kolegji i kësaj gjykate, ti eliminoj të gjitha shkeljet e theksuara më lartë, të vendos në kuptim të nenit 160 të LPK-së, ashtu që ti administroj në tërsi provat e lëndës, duke ballafaquar dokumentacionin përcjellës të mallit lëndor të zhdoganuar me DUD-in R-22594/30.05.2016, të ofruara nga palët ndërgjyëse, dhe të nxjerr konstatimin se a janë plotësuar kushtet ligjore për t'ia pranuar paditësit, origjinën e saktë për mallin lëndor konform nenit 123 paragrafi 1 pika (d) të UA nr. 11/2009 të Kodit Doganor dhe të Akcizave, ashtu që dokumentacioni i mallit lëndor të jetë i harmonizuar në kuptim të dokumenteve të kërkuara për aplikim të dispozitave që rregullojnë lirimin për qarkullim të lirë të mallrave të deklaruara, ku në këtë rast është dëshmuar me certifikatën e origjinës së mallit lëndor. Andaj, varsisht nga gjendja faktike e provave të administruara, gjykata e shkallës së parë të nxjerr vendim të drejt dhe të bazuar ne ligj.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë**

K.DH.SH.II.nr.1034/22, me datë 15.07.2023

**Kryetare e kolegjit,  
Franciska Zhitija Ymeri**